



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

---

Numri i lëndës: 2023:242623

Datë: 23.11.2023

Numri i dokumentit: 04965322

**PPP.nr.39/23**

**GJYKATA THEMELORE NE PEJË- DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku, në çështjen juridike - përbarimore te kreditorit A.D nga fshati V., Komuna I., të cilin e përfaqëson Amir Bunjaku avokat nga Prishtina, ndaj debitorit Komuna e Istogut- Drejtoria e Arsimit, në bazë të dokumentit përbarimor Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.368/22 i datës 16.08.2023, i formës së prerë me datë 25.09.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.10.2023, nga baza juridike borxh në shumë prej 730 euro, caktuar me urdhrin përbarimor të Përmbauesit Privat Argjent Xheladini në Prishtinë P.nr.251/23 të datës 10.10.2023, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancës gjyqësore me datë 23.11.2023 bie këtë:

**AKVENDIM**

**REFUZOHET NË TËRËSI SI I PABAZUAR**, prapësimi i debitorit Komuna e Istogut, i parashtruar kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit të Përmbauesit Privat Argjent Xheladini në Prishtinë P.nr. 251/23 të datës 10.10.2023.

**ARSYETIM**

Kreditori, ka parashtruar propozim për lejimin e përbarimit të Përmbauesi Privat Argjent Xheladini në Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Istogut, në bazë të dokumentit Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.368/22 i datës 16.08.2023, i formës së prerë me datë.25.09.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.10.2023, nga baza juridike borxh në shumë prej 730 euro.

Përmbauesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit ka caktuar urdhërin për përbarim P.nr.251/23 të datës 10.10.2023.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përbarimor me datën 25.10.2023 duke theksuar se: përmbauesit privat nuk mund

të lejojn përbarimin, në kontestet që rrjedhin nga mardhënja e punës, për këtë ka kompetencë vetëm gjykata, dhe përbaruesi privat nuk mund të merr taksen në emër të shpenzimeve të përbaruesit privat sepse kjo është në kundërshtim me Udhëzimin Administrative MD-01/22 përkatësisht me nenin 8 të këtij udhëzimi.

I autorizuari i kreditorit ka dhënë përgjigje në prapësim duke shtuar së prapësimi është i pabazuar ngase në bazë të Ligjit nr. 08/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimine Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-118, përbaruesi privat është kompetent për të vendosur në procedurën e përbarimit dhe zbatimin e përbarimit të vendimeve gjyqësore, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës dhe tarifata e përbaruesit privat janë të rregulluara me Udhëzimin Administrative MD-01/22 përkatësisht neni 4, par.2.

Gjykata në procedurë përbarimore pas shqyrtimit dhe vlerësimit të prapësimi të debitorit, si dhe shkresave tjera të lëndës konstatoj se i njëjti nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, në bazë të të cilave shkaqe gjykata duhet ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Gjykata, prapësimin e debitorit, e refuzoi si të pabazuar, duke ju referuar dokumentit përbarimore përkatësisht Aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.368/22 i datës 16.08.2023, i formës së prerë me datën .25.09.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.10.2023, e duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 24 të LPP-së i cili përcakton se: vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për mosveprim ose veprim është i pambarueshëm po që se është i formës së prerë, prandaj në rastin konkret dokumenti përbarimor në bazë të të cilit është lejuar përbarimi është i plotfuqishëm, dispozitivi i tij i përshtatshëm dhe i përmbarueshëm, dhe i përcaktuar qartë detyrimi i palës debitorë ndaj kreditores.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke ju referuar edhe parimit të legalitetit rigoroz formal, ku gjykata në procedurë përbarimore nuk ka tagër të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë materiale dhe të rregullsisë së dokumentit përbarimor (titullit ekzekutiv), në bazë të të cilit e lejon përbarimin, ngase në procedurë civile nuk lejohet gjykim i ri midis palëve të njëjta për çështjen juridike për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë.

Poashtu gjykata i refuzoi kërkesën e debitorit për shtyrjen e ekzekutimit të aktvendimit mbi lejimin e përbarimit, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 54 par. 1 pika 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përbarimore edhe pasi të ketë përfunduar përbarimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t'ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përbarimit, në qoftë se

dokumenti përmbaret me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 par. 1 të LPP-së i cili përcakton se: gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, konformë dispozitave ligjore të nenit 67 par.1 pika 1, nenit 71, dhe nenit 73 par.3 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE NE PEJË- DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm,  
Divizioni Civil PPP.nr.39/23, datë 23.11.2023**

**G j y q t a r j a**  
Pajtesë Boshnjaku

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.